



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3156/5 Prot.

Pogradec, më 14 . 08 . 2023

VENDIM
NR. 84 , DATË 11 . 08 . 2023
PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.132,DATË 22.11.2022,
PËR “MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË
POGRADEC”,**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23 pika 12, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, si dhe Relacionit të Qendrës Arsimore, me propozim të kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1.Të miratojë ndryshimin e pikës II.17 “Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.132,datë 22.11.2022, për “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec”,si më poshtë:

II.17 Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe:

Tarifë për kopshtet	Njësi	Vlerë
Tarifë për kopshte	Kuota mujore lekë/fëmije	3960
Tarifë për çerdhet	Njësi	Vlerë
Tarifë për çerdhet	Kuota mujore lekë/fëmije	3300

2. Ngarkohet Qendra Arsimore për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

